

INDEKSIMI I ÇMIMEVE PËR BARNAT E RIMBURSUESHME

7.5 milion dollarë do të kursehen nga fondet publike pas vendimit më të fundit të Qeverisë lidhur me indeksimin e çmimeve për barnat e listës së rimbursueshme. Fondet e kursyera do të përdoren për rritjen e numrit të përfituesve nga skema e rimbursimit të barnave dhe zgjerimin e alternativave të mjekimit për të sëmurët kronikë. Buxheti i shtetit financon çdo vit 100 milionë dollarë për barnat e rimbursueshme, nga të cilat përfitojnë pa pagesë 498 mijë banorë.

PROGRAMI 300 QENDRAVE SHËNDETËSORE

4100 banorët e Kolonjës në Lushnje e marrin shërbimin me kushte dhe standarde bashkëkohore. Qendra e rehabilituar e Kolonjës është pjesë e programit të rindërtimit të 300 qendrave shëndetësore dhe ambulancave në gjithë vendin.

KUJDESI SHËNDETËSOR PARËSOR

Poliklinika e qytetit të Lushnjes, që përfshin edhe dy qendrat më të mëdha shëndetësore të qytetit po rehabilitohen tërësisht për të ofruar kushte bashkëkohore për 186 mijë banorët e qytetit të Lushnjes. Vijnë investimet në kujdesin shëndetësor parësor, me rehabilitimin e 100 qendrave të tjera shëndetësore, brenda vitit 2019.

PUNËSIMI I MJEKËVE TË RINJ

Vetëm gjatë muajit Shkurt, 66 mjekë të rinj janë punësuar në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor. Pas përfundimit të konkursit transparent, të shpallur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, mjekët e përgjithshëm po ofrojnë shërbim në qendrat shëndetësore dhe ambulancat nga veriu në jug të vendit.

TAKIMET E HAPURA/ REGJIMI I RI NË SPITALE

Në spitalin e Kavajës vijuan takimet e hapura me qytetarët, mjekët dhe infermierët për riorganizimin e sistemit tonë shëndetësor, duke nisur nga vendosja e një regjimi të ri në spitale, me zbatimin rigoroz të disiplinës dhe rregullit. Ky regjim i ri ndihmon mjekët dhe infermierët të bëjnë më mirë punën e tyre, pacientët të marrin shërbimin e duhur mjekësor dhe familjarët të jenë më të kënaqur me shërbimin. Takimet e hapura do të vazhdojnë në të gjitha spitalet e vendit.

FUQIZIMI I SPITALEVE RAJONALE

Është kryer për herë të parë një ndërhyrje laparoskopie në spitalin rajonal të Vlorës. Ndërhyrja u realizua falë investimit në aparaturën moderne të laparoskopisë dhe ndërveprimit mes ekipeve mjekësore të spitaleve rajonale të Vlorës dhe Fierit. Qytetarët nuk do të kenë nevojë të udhëtojnë nga Vlora drejt Tiranës, pasi falë investimeve në spitalet rajonale, garantojmë shërbime cilësore afër vendbanimit.

LIGJI I RI I KUJDESI SHËNDETËSOR

Këshilli i Ministrave ka miratuar ndryshimet ligjore në ligjin për "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë". Qëllimi i ndryshimeve ligjore lidhet me përmirësimin e ofrimit të shërbimit shëndetësor. Miratimi i ndryshimeve ligjore sjell ndryshime që lidhen me profesionistët e shëndetësisë dhe edukimit të tyre të vazhdueshëm, auditin klinik, sistemin e informacionit shëndetësor elektronik dhe mbikqyrjen e institucioneve. Për herë të parë me ligj përcaktohet punësimi i profesionistëve të shëndetësisë anëtarë të urdhërit të infermierit, nëpërmjet portalit "Infermierë për Shqipërinë"